

VENDIM
Nr.839, datë 22.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SHIJAK TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 24 (njëzet e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 105 (njëqind e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-7	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
8,9,104,105	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
15-17	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
40-43, 45 (VETËM TROJET)	INFRASTRUKTURË (TROJE TË LIRA)	NË PËRDORIM
18-39, 44 40-43, 45 (VETËM SHESHET) 46-49	INFRASTRUKTURË (SHESHE, RRUGË VENDORE, LULISHTJE DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
50-53	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK.	NË PRONËSI
54-65	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E STREHIMIT DHE TË MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
97,98	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
96,99	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (KANALE TË TRETA DHE TOKA JO PRODUKTIVE).	NË PRONËSI